



Siguria dhe Punët e Brendshme

Shkurt 2022



LEJE QËNDRIMI PA AFAT PËR SHTETASIT E KOSOVËS

Ministri i Brendshëm Bledi Çuçi u dorëzoi publikisht dy të rinjve nga Kosova, kartat biometrike që janë njëherësh leje qëndrimi dhe leje pune 5-vjeçare. Veçantia e këtyre dokumenteve është se ato janë të rinovueshme automatikisht në përfundim të afatit të shënuar. Procedurat për aplikim dhe marrjen e kartave janë të lehta dhe bëhen online. Implementimi i tyre do të krijojë kushtet e përshtatshme që shqiptarët në të dy anët e kufirit të lëvizin dhe jetojnë pa pengesa.



NIS SHKOLLA E POLICISË PËR FORMIMIN BAZË PËR 500 STUDENTË

500 studentë të rinj nisën studimet në Akademinë e Sigurisë, për kursin "Patrullë e Përgjithshme". Përzgjedhja e tyre u bë me konkurs të hapur ku morën pjesë qindra e mijëra të rinj të interesuar. Pas një viti studimesh dhe përgatitjeje profesionale, këta të rinj e të reja do të bëhen pjesë e trupës së Policisë së Shtetit, duke kontribuar në përtëritjen e saj. Ministria e Brendshme ka 5-fishuar investimet në pajisje teknologjike duke synuar

ndërtimin e një policie moderne, në struktura dhe në vizion. #Shqipëria2030



TË HUAJT NË SHQIPËRI, NIS APLIKIMI PËR LEJE QËNDRIMI BIOMETRIKE

Shtetasit e huaj që duan të qëndrojnë në Shqipëri, mund të aplikojnë për leje qëndrimi biometrike nëpërmjet platformës qeveritare "a-Albania". Aplikimi duhet të bëhet brenda afatit kohor të 30 ditëve pas hyrjes në territorin shqiptar. Kjo procedurë e re është mjaft e favorshme për të huajt, pasi ata aplikojnë vetëm një herë për leje qëndrimi, e cila është e vlefshme edhe si leje pune. Përmes këtij dokumenti biometrik, të huajt mund të përdorin lehtësisht shërbimet publike që ofron administrata për ta.



FUSHATA PËR SIGURINË RRUGORE

Policia e Shtetit vijon fushatën në shkollat e vendit në kuadër të programit të forcimit të policimit në komunitet i mbështetur nga qeveria suedeze. Gjatë takimit me maturanët në gjimnazin "Myslim Keta" në Tiranë, ekspertët e kësaj fushe këshilluan, dhe shpjeguan rëndësinë e respektimit të rregullave të qarkullimit rrugor, veçanërisht vendosjen e rripit të sigurimit, si dhe mos përdorimin e celularit në timon, kjo për sigurinë e tyre si dhe të përdoruesve të tjerë.



FUSHATA NDËRGJEGJËSUERE 'SHQIPËRIA JE TI'

Janë zhvilluar takime në disa qarqe të vendit për ndërgjegjësimin dhe informimin e shtetasve shqiptarë për emigrimin e rregullt. Kjo qasje bashkëpunuese është materializuar në hartimin dhe miratimin e 4 strategjive kombëtare: Strategjia Kombëtare e Migracionit; Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare; Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit; Strategjia e Punësimit dhe Aftësive..



DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT MESAZH PUBLIK DREJTUAR QYTETARËVE

“Të bashkëpunojmë kundër krimit, për t’u bërë një forcë madhore në emër të së drejtës për të ndërtuar jetën që meritojmë,” është shprehur Drejtori i Policisë Gledis Nano në një mesazh publik drejtuar qytetarëve. Ai ka falënderuar për mbështetjen e dhënë deri më sot duke theksuar se policia është e angazhuar me të gjitha kapacitetin e saj për t’u përballur dhe goditur me vendosmëri krimin e organizuar dhe çdo dukuri kriminale, grupim apo individë të lidhur me ta. “Kjo përballje është luftë pa kthim e pa kompromis, për të arritur rezultatin që e presim bashkërisht: një jetë të denjë për të gjithë dhe ndaj të gjithëve,” është shprehur Nano.